

Në Kirchberg të Bernës promovohet libri "Monografia e Degës së LDK-së në Zvicër"

"Monografia...", kontribut me vlerë për brezat që vijnë

"Monografia e autorit Mr. Shaip Latifi që shënon një pjesë të punës tetëmbëdhjetëvjeçare të veprimtarisë së kësaj dege të LDK-së, është padyshim vlerë e madhe për brezat që do të vijnë" u shpreh kryetari i degës së LDK-së për Zvicër, Haki Latifi në referatin e tij.

Më 19 tetor 2008 në Kirchberg të Bernës, dega e LDK-së në Zvicër organizoi një tubim promovimi të librit "Monografia e Degës së LDK-së në Zvicër", e autorit Mr. Shaip Latifi. Manifestimin e organizoi sektori për kulturë pranë kësaj dege. Fjalën e hapjes e mbajti anëtar i kryesisë Ajet Avdyli ndërsa referatin rreth librit e paraqiti kryetari i Degës së LDK për Zvicër, Haki Latifi. "Monografia e autorit Mr. Shaip Latifi që shënon një pjesë të punës tetëmbëdhjetëvjeçare të veprimtarisë së kësaj dege të LDK-së, është padyshim vlerë e madhe për brezat që do të vijnë" u shpreh z. Latifi në referatin e tij. Pastaj ai kujtoi se "promovimin e parë autori e bëri në Zvicër, më pesëmbëdhjetë qershor, 2008 nëpërmes video projektorit, pikërisht në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ishte ky një përjetim i mirë i mërgimtarëve, kur pas sa vitesh rikujtuan mundin e tyre për qëllim të shenjtë.

Autori, Mr. Shaip Latifi përshkruan periudhën kur për herë të parë shqiptarët në Zvicër u organizuan dhe vendosën lidhje institucionale me institucionet e dala nga vullneti i popullit të Kosovës dhe trojeve etnike shqiptare". Dega e LDK-së në Zvicër, tha më tutje kryetari aktual i saj, është themeluar më 19 prill 1990. Ajo, për një kohë relativisht të shkurtër arriti që në gjirin e vet t'i ketë 55 nëndegë si dhe mbi njëqind aktive rajonale



Haki Latifi, kryetar i degës së LDK-së mban referatin mbi librin

apo siç u quanin në fillim këshilla rajonale. Kjo Degë është e para që themeloi fondin humanitar në vitin 1990 për shkak të organizimit të grevës së përgjithshme popullore në shtatorin e vitit 1990 në Kosovë. Këtë aktivitet ajo e vazhdoi duke ndihmuar të gjitha format e rezistencës së popullit të Kosovës kundër Serbisë", tha z. Latifi. "Jemi të bindur se në këtë monografi është përfshirë vetëm një pjesë e aktivitetit të degës së LDK-së në Zvicër. Aty paraqitet aktiviteti i kësaj dege si themeluese e fondit gjithëkombëtar, themeluese e fondit të qeverisë së Republikës së Kosovës në egzil - tre përqindësit etj". Kjo degë, sipas folësit ka meritat e saj edhe për themelimin e LASH-it, "për organizimin e 10.000 tubimeve me bashkatdhetarë, të dhjetëra protestave e demonstratave në Bernë, Gjenevë etj. për gjenocidin që bëhej në Kosovë nga okupatori serb. Dega e këtushme e

LDK-së priti dhe përcolli shumë herë kryetarin historik, të ndjerin Dr. Ibrahim Rugova dhe bashkëpunëtorë të kryetarit gjegjësisht udhëheqës të institucioneve të Kosovës etj. Dega, ka thënë më tutje kryetari i saj, "krahas lëvizjes paqësore ndihmoi edhe rezistencën e armatosur kundër okupatorit serb në luftën e fundit. Andaj jo rastësisht kjo degë dhe mërgimtarët shqiptarë në Zvicër ishin krahu më i fortë i LDK-së, i popullit të saj, të vlerësuar shumë edhe nga Kryetari dr. Ibrahim Rugova". Në vazhdim z. Latifi tha se "nëpër mes kësaj monografie një falënderim i veçantë i dedikohet edhe ndihmës që dhanë miqtë e popullit shqiptar" me ç'rast falënderohet populli dhe shteti i Zvicrës, që priti e përcolli mijëra të strehuar nga Kosova.

Një vështrim kushtuar librit e lexoi anëtar i kryesisë së degës, Nazmi Peci, i cili po ashtu çmoi lartë punën e autorit Shaip Latifi në realizimin e këtij libri.

Manifestimi u plotësua edhe me disa pika muzikore: potpuri vallesh nga shoqëria "Ardmëria" e Neuchatelit dhe me disa këngë nga këngëtarit Nexhmedin Gaxherri.

Nga Aktiviteti i LDD-së, Langenfeld, Gjermani

Formohet këshilli iniciues për themelimin e nëndegës së LDD-së

Në një informatë për media, komisioni për informim i LDD-së, Gjermani njofton për formimin e një këshilli nismëtar për themelimin e një nëndegë të re të kësaj partie në Gjermani.

"Kryesia e nëndegëve të LDD-së në NRW e udhëhequr nga kryetari, Hilmi Gashi, ka arritur që gjer më sot të themelojë 13 nëndegë të LDD-së në këtë land, në një periudhë të shkurtër kohore", thuhet në informatë. Kështu, vazhdon njoftimi, në Langenfeld, në mbledhjen ku ishte i pranishëm Hilmi Gashi, kryetar i nëndegëve të LDD-së për NRW, më 18.10.2008, u formua Këshilli Iniciues për themelimin e Nëndegës së 13 me radhë të LDD-së në Landin e NRW-së, e cila përfshinë edhe qytetet Leverkusen dhe Solingen.

Gjatë diskutimeve me bashkatdhetarët, kryetari i nëndegëve të LDD-së, në NRW, pasi ua bëri të qartë programin dhe statutin, tha se, "LDD-ja është një parti politike e

Mbledhje e nëndegës së Böblingen - Sindelfingenit

Njoftohen anëtarët dhe simpatizuesit e LDD-së, se nëndega e LDD-së nga Böblingen-Sindelfingeni do të mbajë mbledhjen e saj të rregullt më 26.10.08 duke filluar nga ora 17.00. Adresa: Bahnhofstrasse 30, Böblingen
Për informata mund të drejtoheni në këtë numër telefoni: 015225470058

cila ka marrë në mbrojtje mërgatën shqiptare, e cila u harrua dhe u nëpërkëmb, qysh nga dita kur u nda nga jeta Presidenti historik Dr. Ibrahim Rugova".

Në vazhdim u zgjodh Këshilli Iniciues i Nëndegës së LDD-së, ku për kryetar u zgjodh Behxhet Zeqiri, Adem Baliu sekretar, kurse

Ramadan Osmani u zgjodh arkëtar i nëndegës së LDD-së për Langenfeld. Përrurimi dhe zgjedhja e Kryesisë së Nëndegës së LDD-së në Langenfeld u vendos të bëhet me datën 25.10.2008", thuhet veç tjerash në informatën e dërguar nga Komisioni për informim i LDD-së në Gjermani.

Suksese të aktorit tonë

Blerim Destani në dy projekte ndërkom-bëtare filmash

Që nga mesi i tetorit Blerim Destani ka shkruar për të xhiruar një film në Zelandën e Re, me koleget e tij si Rhona Mitra (Lara Croft, Shooter, Nummer 23), Thomas Kretschmann (King Kong, Der Untergang, Wanted) dhe Joel Edgerton (Star Wars 2, Star Wars 3, König Artur). Destani luan në filmin "Separation City" ku është angazhuar në rolin e një dirigjenti, me të cilin aktorja kryesore Rhona Mitra bie në dashuri. Filmi tani është duke xhiruar nën drejtimin e regjisorit Paul Middleditch në Zelandë të re si dhe në Berlin të Gjermanisë.

Pas xhirimeve të filmit Separation City, i cili del në kinema në vitin 2010, Blerim Destani do ta luajë rolin e një kameramani në filmin komik "At World's End". Në këtë produksion gjerman-danez-australian, Destani do ta drejojë potencialin e tij në fushën e kinematografisë. Në këtë produksion merr pjesë edhe aktori i mirënjohur Ste-



phen Berkoff, i cili më parë luante në filma holivudian si "Beverly Hills Cop" dhe "James Bond Octopussy". Filmi do të xhirohet në Australi nga fundi i tetorit. Tani është e vendosur që pas daljes në kinema, filmi do të emetohet edhe në televizionin gjerman ZDF.

Blerim Destani bëri emër me produksionin ndërkombëtar "Time of the Comet - Koha e Kometës" dhe fitoi çmimin "Golden Gladiator for Best Film".

Elife Kurteshi

Më 29 tetor

Bëhet përrurimi i pllakës së falënderimit të Kosovës drejtuar Zvicrës

Në manifestimin e zbulimit të pllakës, në Cyrih më 29 tetor do të jenë të pranishëm: Fatmir Sejdiu, president i Republikës së Kosovës, Micheline Calmy Rey, ministre e jashtme e Zvicrës si dhe kryetari i qytetit të Cyrihut, Elmar Ledergerber.

Sipas një njoftimi të dërguar nga presidenca e qytetit të Cyrihut, respektivisht nga zyra për medie e kryetarit të këtij qyteti Elmar Ledergerber, konfirmohet se më 29 tetor 2008, e mërkurë, në Cyrih do të bëhet zbulimi i pllakës së granitit me moton "Faleminderit Zvicër", përmes të cilës kosovarët falënderojnë shtetin dhe popullin e Zvicrës për gjithë atë që kanë bërë për ta, gjatë viteve të luftës në Kosovë, më parë dhe më pastaj. Iniciativa për realizimin e kësaj pllake ka filluar para rreth dy vitesh nga aktivistë shqiptarë dhe miq të tyre zviceranë. Së fundi, nismën e ka zyrtarizuar shoqata "Pro Kosova", e cila ka vendosur lidhjet dhe kontaktet e nevo-

jshme mes institucioneve zvicerane dhe atyre të Kosovës. Si rezultat, në manifestimin e zbulimit të pllakës, në Cyrih më 29 tetor do të jenë të pranishëm edhe personalitetet më të larta të të dy vendeve: Fatmir Sejdiu, president i Republikës së Kosovës, Micheline Calmy Rey, ministre e jashtme e Zvicrës si dhe kryetari i qytetit të Cyrihut, Elmar Ledergerber. Këta do të mbajnë fjalime në sheshin ku do të vendoset pllaka dhe me këtë rast do të shfaqet edhe një program kulturor artistik nga shoqëri të ndryshme të komunitetit të këtushëm shqiptar.

Për hollësitë tjera rreth këtij manifestimi do të ju njoftojmë në numrat në vazhdim të gazetës.

Nga 20 tetori në Gjenevë

Ekspozitë e piktores Miradije Ramiqi

Nga 20 tetori deri më 7 nëntor në Gjenevë, do të qëndrojë e hapur ekspozita e piktores së njohur nga Kosova, Miradije Ramiqi. Solemniteti i hapjes së ekspozitës mbahet më 23 tetor, fillon nga ora 18 dhe zgjat deri në orën 20.30.

Ekspozita mbahet në ambientet e Centre William Rappart Organisation Mondiale du Commerce. Ajo mund të vizitohet nga e hëna deri të premtën nga ora 8.30 deri në orën 17.30. Adresa: 154, Rue de Lausanne, 1211 Geneve 21. Info: 0786113179.

Të shtunën në Zëri: intervistë ekskluzive me Arjeta Zhutën

Arjeta Zhuta mund të përfaqësojë Zvicrën në "Eurosong 2009"

Këngëtarja shqiptare -zvicerane me rrënjë nga Struga (fshati Veleshtë), Arjeta Zhuta, ka gjasat të mira që të përfaqësojë Zvicrën në Eurovizionin 2009, që do të mbahet vitin që vjen, në Moskë. Shumë medie zvicerane raportojnë për këtë synim të struganes simpatike të njohur me nofkën "Ari", dhe i japin shanse mjaft serioze që t'i sigurojë më në fund Zvicrës një përfaqësim me nivel në këtë festival. Arjeta është bërë e njohur në dy vitet e fundit

me pjesëmarrjen e saj të suksesshme në garat për zgjedhjen e "super starit" të këndimit, në Zvicër dhe në Gjermani. Në të dyja konkurset ajo kishte bërë emër të mirë dhe ishte dalluar me këndimin e saj, ndonëse nuk

kishte arritur të plasohet në listën e synuar.

Në numrin e të shtunës të gazetës sonë, lexuesit do të kenë mundësinë të lexojnë intervistën ekskluzive të Zërit me Arjeta Zhutën.



Arjeta Zhuta